



Nr. 1726/2 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 28/03 2018

FTESË PËR NEGOCIATA

I.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare)
Adresa Rr. Eshref Frashëri, hyrja 8/1, P. Vizion, Tiranë
Tel/Fax+355 04 225 8977
E-mail mail@kesh.al
Adresa e Internetit ëëë.kesh.al

I.2 Emri dhe adresa e personit përgjegjës:

Emri Juli Binjaku
Adresa Rr. Eshref Frashëri, hyrja 8/1, P. Vizion, Tiranë
Tel/Fax 0692960953
E-mail binjakuj@kesh.al

Autoriteti Kontraktor KESH sh.a do të zhvillojë procedurën e botimit të njoftimit "**Botimin e Ftesës për Ofertë për procedurën e prokurimit "Shërbime Konsulence për Menaxhim Financiar dhe Ndërtimi i Kapaciteteve."**, me fond limit me vlerë 100,000 (njëqind mijë) lekë.

Nevoja për kryerjen e botimit: Në referencë të kërkesës së njesisë PMU dërguar me email datë 27.03.2018, në përputhje me udhëzuesin e KFË, është kërkuar realizimi i botimit të njoftimit, Kërkesë për shprehje interesit.

Shpeshtësia e shfaqjes se reklames: 2 (dy) ditë, e premtë e shtunë në datat 30-31 Mars 2018.

Përmbajtja: Shpallje në gjuhën Shqipe dhe Angleze, në ½ faqe të një gazete, pa ngjyra;

Fondi limit i percaktuar: 100,000 (njëqind mijë) Lek;

Afati i fundit për paraqitjen e konfirmimeve nga organet e masmedias/ agjencitë e specializuara është deri më dt. 29.03.2018, në orën 13.00, pranë Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare sh.a.

Konfirmimet: Konfirmimet duhet të vijnë të gjitha në një ditë të vetme, të mbyllura në zarf, të shënuara me adresën dhe emërtimin e subjektit, në rast të kundërt ato do të refuzohen dhe do të kthehen të pahapura. Konfirmimet duhet të jenë në gjuhë Shqipe.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë autoritetit tonë kontraktor konfirmimet tuaja.

Dokumentacioni ligjor që duhet paraqitur si kriter kualifikues:

1. Ekstrakti i QKR, që vërteton se operatori ushtron këtë aktivitet ekonomik tregtar.
2. Dokument që vërteton se operatori ekonomik ka shlyer detyrimet fiskale për vitin 2017.

Dokumentacioni të jetë origjinal ose kopje e noterizuar i lëshuar brenda 3 muajve të fundit (vërtetimet e QKR dhe administratës tatimore)

Përzgjedhja dhe vlerësimi i ofertave:

Përzgjedhja e ofertave sipas pikës nr. 7 dhe 12 te VKM nr. 1195 datë 05.08.2008

- **Vlerësohet me 50 pikë faktori i impaktit:**

Faktori i impaktit është masa në të cilën artikulli/njoftimi do të aksesohet nga personat që mund të shfaqin interes, për shkak të tirazhit dhe informacionit të përcjellë nga periodiku.

- **Vlerësohet me 50 pikë oferta më e ulët** ekonomike e operatorit.

Oferta ekonomike do të jetë e paraqitur në Lek.

Ofertuesit kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e hapjes së ofertave përfaqësuesit apo personat me autorizim.

Ofertat duhet të jenë të mbyllura në zarf, të vulosura dhe do të dorëzohen nga përfaqësuesit e shoqërive pranë KESH sh.a. ose para komisionit në datën dhe orën e përcaktuar.

Komisioni nuk do të pranojë asnjë ofertë e cila do të dorëzohet tej afatit të përcaktuar dhe jo në përputhje me kërkesat e mësipërme.

Jemi në pritje të konfirmimit tuaj për negociim.

DREJTOR I KABINETIT
Taulant HOXHA

